

13 shkurt, 2007

Komunikatë për media

Agjencia Kosovare e Mirëbesimit shpall Valën 23 të Privatizimit

PRISHTINË – Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM) sot zyrtarisht shpalli valën 23 të Privatizimit të Ndërmarrjeve Shoqërore (NSH). Menjëherë pas mbledhjes së Bordit të mbajtur më 1 shkurt, AKM-ja ka njoftuar menaxhmentin e NSH-ve dhe Komunat përkatëse për privatizimin e këtyre ndërmarrjeve, ndërsa sot i ka postuar njoftimet për tender në faqen e AKM-së në internet, www.kta-kosovo.org.

Në listën e tenderëve të privatizimit të valës së 23-të janë përfshirë 20 Ndërmarrje Shoqërore (NSH), nga të cilat janë krijuar 25 Ndërmarrje të Reja (Ndër. të Reja).

19 NSH do të privatizohen përmes spinof-it të rregullt, ku do të krijohen 24 Ndër. të Reja, ndërsa 1 NSH do të privatizohet përmes spin ofit special, duke krijuar 1 Ndër. të Re.

Afati i fundit për parakualifikim është me 11 prill, 2007.

Data për dorëzimin e ofertave është me 18 prill, 2007.

Bashkangjitur në këtë komunikatë për media mund të gjeni listën e plotë të kompanive:

Spin-ofet e Rregullta:

Ndërmarrja e Re “Produkti Vendor” Sh.P.K. - ofron mundësi të shkëlqyeshme për blerjen e hapësirës komerciale dhe vend të gjerë deponimi si dhe lokacion te mire për zgjerim biznesi, te vendosur ne dy lokacione te ndara por afër njëra tjetrës ne periferi te Ferizajt. Sipërfaqja totale e zyrave dhe depove është përafërsisht 3,434 m² (0.34.34 ha).

Ndërmarrja e Re Morava e Binçës Administrata Sh.P.K. - tenderi i jep mundësi investitorit të blej njërën prej ndërtesave më të mëdha administrative në Gjilan të vendosur në një lokacion te shkëlqyeshëm të qytetit. Prona subjekt i këtij tenderi ka një sipërfaqe toke prej përafërsisht 21750 m² (2 ha 17 ar 50m²). Ndërtesa Administrative

mbulon sipërfaqe prej përafërsisht 836 m² dhe ka P+3 kate me sipërfaqe të përgjithshme të kateve të përafërt me 2580m². Ndërtesat tjera ndihmëse mbulojnë sipërfaqe prej përafërsisht 2830 m².

Ndërmarrja e Re Morava e Epërme “Shtëpia e Mallrave e Vitisë” Sh.P.K. - kjo Ndërmarrje e Re është një rast shumë i mirë për blerjen e shtëpisë së mallrave së bashku me hapsirën për zyre, e vendosur në qendrën e qytetit. Ky është një rast i veçantë komercial. Hapësira totale e shtëpisë së mallrave së bashku me zyret është përafërsisht prej 2500 m².

Ndërmarrja e Re Pylltaria Kodra e Koshutanit - Çubrel, Skenderaj Sh.P.K. - i ofron investitorit potencial mundësinë ideale për të përfituar rreth 5.12.06 m² (5ha 12are 06m²) tokë (kullosë) të përshtatshme për çdo llojë veprimtarie dhe me një lokacion shumë të mirë afër rrugës kryesore Skenderaj-Pejë.

Ndërmarrja e Re Ferma Picel - KB 23 Nëntori Sh.P.K. - përfshin një sipërfaqe të kullosës rreth 632,115 m² (63 ha 21 ari) të cilat gjenden në lokacionin Picel në fshatin Bajgorë , komuna e Mitrovicës.

Ndërmarrja e Re Malishqan Tokë Bujqësore Jashanicë Sh.P.K. - përfshin rreth 193 ha të tokës pjellore bujqësore në Klinë. Në këtë tender NUK përfshihen kurrfarë ndërtesa, bagëti apo asete të lëvizshme.

Ndërmarrja e Re Toka Bujqësore Shaptej dhe Gramogel Sh.P.K. - i ofron investitorit një sipërfaqe prej rreth 170 hektarësh të tokës së punueshme bujqësore . Toka bujqësore e tenderuar përdoret për kultivimin e kulturave të ndryshme bujqësore, si gruri, elbi, tërshëra, etj.

Ndërmarrja e Re Toka Bujqësore Glllogjan dhe Irznig Sh.P.K. - i ofron investitorit një sipërfaqe prej rreth 125 ha tokë të punueshme bujqësore në komunën e Deçanit. Toka bujqësore e tenderuar është e përshtatshme për kultivimin e kulturave të ndryshme bujqësore.

Ndërmarrja e Re Malishqan Bingjë Tokë Bujqësore Sh.P.K. - përfshin vetëm tokën e punueshme të Ndërmarrjes prej përafërsisht 142 hektarësh në komunën kadastrale Bingjë të Komunës së Klinës duke premtuar potencial të lart për rimarrjen e pjesëmarrjes të rëndësishme të kulturave të ndryshme dhe perimeve.

Ndërmarrja e Re Shtoria Mulliri Ferizaj Sh.P.K. - siguron investitorëve mundësinë e ofrimit të lokalit komercial në rrugën Ali Kelmendi e cila gjendet në pjesën jugore nga qendra e Ferizajit. Aseti përfshin sipërfaqen përafërsisht prej 36 m².

Ndërmarrja e Re Shtoria Mulliri Fushë Kosovë Sh.P.K. - siguron investitorëve mundësinë e ofrimit të lokaleve komerciale me sipërfaqe përafërsisht prej 89.61 m² i cili gjendet në rrugën Nëna Tereze Fushë Kosovë. Asetet përfshijnë dy dyqane të vendosura në përdhese të ndërtesës njëri dyqan gjendet përball rrugës kryesore me sipërfaqe përafërsisht prej 55.5 m² dhe dyqani tjetër në anën e pasme të kësaj ndërtese me sipërfaqe përafërsisht prej 34.11m².

Ndërmarrja e Re Pashtriku Sh.P.K. - siguron investitorëve potencial mundësinë për përfitimin e një lokalit afarist dy-katesh me lokacion strategjik në Dardani, Prishtinë. Lokali është në gjendje relativisht të mirë, me sipërfaqe përafërsisht prej 325 m².

Ndërmarrja e Re Besa Tokë Bujqësore Sh.P.K. - ofron tokë shumë të mirë bujqësore si dhe ndërtesa administrative gjendet në lokacion shumë strategjik. Me investime të vogla do të ketë rritje të prodhimeve.

Ndërmarrja e Re Injenering Dardania Dyqani Sh.P.K. - ofron mundësi për fitimin e një dyqani me rreth 807m². Dyqani duket të jetë në gjendje të mirë dhe gjendet në përdhese të një ndërtese banesore BL-7 në Dardani, Rruga Ilaz Kodra në Prishtinë. Aktualisht është i lëshuar me qira për afarizëm.

Ndërmarrja e Re Injenering Dyqanet te Tregu Sh.P.K. - ofron mundësi për fitimin e pesë dyqaneve në qendër të Prishtinës/Priştina. Dyqanet gjenden në katin e parë dhe të dytë të Qendrës Tregtare e cila gjendet afër Tregut të Gjellbër – Rruga Maliq Pashë Gjinolli në Prishtinë. Sipërfaqja e përgjithshme e dyqaneve është rreth 59 m². Dyqanet duket të jenë në gjendje të mirë dhe aktualisht janë të zbrazura.

Ndërmarrja e Re 28 Nëntori – Fabrika e Mobilieve Sh.P.K. - i ofron investitorit mundësinë për të fituar një Fabrikë të Mobilieve me objektet tërheqëse të deponimit me një sipërfaqe të vetme prej përafërsisht 6,485.32 m² më një lokacion në qendrën e qytetit të Podujevës, shumë atraktivë për veprimet komerciale.

Ndërmarrja e Re Maqjistrala Peja Sh.P.K. - ofron rast unik për të marrë një copë toke prej përafërsisht 30865 m² që përfshin dy ndërtesa me përafërsisht 432 m² që gjenden afër qendrës së Pejës. Ky njësit ka disa paisje për mirëmbajtjen e rrugëve, pastrimin e rrugëve nga bora, mirëmbajtjen e ndriçimit rrugorë etj.

[Ndërmarrja Re Sharrprodhimi "Fermat në Mejdani" Sh.P.K.](#) - do të përfshijë në sipërfaqe totale të përafërt me 450 hektarë të tokës duke përfshirë edhe ndërtesa (7) secila prej të cilave ka në sipërfaqe të përafërt me 1,500 m² të cilat janë të regjistruara në emër të NSH-s.

[Ndërmarrja e Re Zhupa Reçan – Supermarketi në Lubinjë e Poshtme Sh.P.K.](#) - përfshin Supermarketin I cili gjindet në pjesën atraktive të fshatit Lubinjë e Poshtme, me një sipërfaqe prej përafërsisht 3 ari e 21 m² që përfshin ndërtesën 2 katëshe me sipërfaqe totale prej 260m² dhe 61m² oborr të regjistruara në emër të NSH-së.

[Ndërmarrja e Re Mirusha "Vreshtat/Toka Bujqësore Banië" Sh.P.K.](#) - përfshin vreshta (jo aktiv), gjithashtu dhe tokë lavërtare me një sipërfaqe përafërsisht prej 1,100 hektarësh dhe duke përfshirë një numër të ndërtesave me një sipërfaqe totale të përafërt prej 2,200 m². Ndërmarrja e Re ofron sipërfaqe të mjaftueshme tokësore të përshtatshme për prodhimin e rrushit si dhe kultivimin e drithërave të ndryshme në shkallë industriale. Kushtet klimatike gjithashtu dhe toka i mundësojnë pronarit të ardhshëm kultivimin e rrushit.

[Ndërmarrja e Re Mirusha "Vreshtat/Toka Bujqësore Malishevë" Sh.P.K.](#) - përfshin vreshta (jo aktiv), gjithashtu dhe tokë lavërtare me një sipërfaqe përafërsisht prej 400 hektarësh dhe duke përfshirë një numër të ndërtesave me një sipërfaqe totale të përafërt prej 3,000 m². Ndërmarrja e Re ofron sipërfaqe të mjaftueshme tokësore të përshtatshme për prodhimin e rrushit si dhe kultivimin e drithërave të ndryshme në shkallë industriale. Kushtet klimatike gjithashtu dhe toka i mundësojnë pronarit të ardhshëm të mirret me kultivimin e drithërave dhe prodhimeve tjera bujqësore.

[Ndërmarrja e Re Liria Shitoret "Sheshi i Lidhjes se Prizrenit" Sh.P.K.](#) - përfshin një kompleks për shitje me pakicë në qendër të qytetit të Prizrenit, i cili aktualisht është i ndarë në dy shitore dhe ka një sipërfaqja totale prej përafërsisht 397.59 m². Aktualisht një shitore është e dhënë me qira palës së tretë ndërsa një është aktualisht e mbyllur.

[Ndërmarrja e Re Liria Shitorja "Dardania" Prishtinë Sh.P.K.](#) - përfshin një kompleks për shitje me pakicë në qendër të qytetit të Prishtinës në lagjen "Dardania" që përmban një shitore (përdhese dhe bodrumi) me një sipërfaqe totale prej përafërsisht 159.63 m². Aktualisht shitorja është e dhënë me qira nga ana e Ndërmarrjes.

[Ndërmarrja e Re "Thertoria-Exportuese" Sh.P.K.](#) - është një kompani atraktive të përpunimit të mishit dhe është i vetmi prodhues i licencuar në regjion e Prizrenit. Ndërmarrja prodhuese gjendet në zonën industriale dhe ka një sipërfaqe përafërsisht 1.76.61 hektarësh, duke përfshirë 3 njësitë punuese dhe ndërtesën e administratës.

Spinofi special:

[Ndërmarrja e Re Minex Sh.P.K.](#) - objektet lëndë e këtij spin-off janë të vendosura në periferi të qytetit të Ferizajit, regjioni i Gjilanit dhe përfshin një numër ndërtesash me përafërsisht 8.500 m² të sipërfaqes së përgjithshme të pajisura për prodhimtari ushqimor. Objektet shtrihen përafërsisht në tre hektare toke, një pjesë e së cilës mund të shfrytëzohet për përpunime alternative.

Shënim: Ofertuesit duhet të kenë parasysht për kushtet specifike të shitjes në lidhje me investimet e kredituara dhe punësimin e stafit të bashkangjitur në kete tender.

Fund